



QENDRA E TRAJNIMIT "BLITERMENG"



BLITERM ENG
Protec Consulting Group

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR SPECIALIST TË AVANCUAR TË SSHP-SË (Ndërtim, Prodhim, Miniera, Transportë, Bujqësi)

Prishtinë, 2025



1. PREZANTIMI I MODULIT NË FUSHËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP)

Siguria dhe Shëndeti në Punë është një modul thelbësor që mundëson zhvillimin e aftësive profesionale për kontrollin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës. Ky modul është relevant për çdo profesion dhe për çdo fazë të procesit të punës, duke pajisur punëdhënësit dhe të punësuarit me aftësi të transferueshme që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm.

Analiza dhe parandalimi i rreziqeve shpesh shoqërohen me situata të pasigurta; megjithatë, ekzistojnë "praktika të mira", të cilat, kur zbatohen në mënyrë profesionale, mundësojnë reduktimin dhe shmangien e aksidenteve, incidenteve dhe dëmtimeve të mundshme.

Qendra e Trajnimit BLITERM ENG, përmes njësisë së saj PCG – Protec Consulting Group, vepron në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale. E bazuar në Rregulloren Nr. 01/2021 mbi Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Licencimin e Kompanive të SSHP-së, si dhe në Licencën Nr. 05/2021 të MFPT-së, Qendra ofron programe moderne, të standardizuara dhe të përshtatura për aplikim praktik në mjediset e punës. Programet janë të harmonizuara me legjislacionin vendor, me standardet evropiane dhe me standardet ndërkombëtare ISO, veçanërisht ISO 45001 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Në përputhje me Rregulloren (MPMS) Nr. 01/2021, janë përcaktuar edhe veprimtaritë me rrezikshmëri të lartë, përfshirë:

- Ndërtimtarinë
- Prodhimtarinë
- Minierat
- Transportin
- Bujqësinë dhe Pylltarisë

Qëllimi i programit është të përgatisë Specialistë të Avancuar të SSHP-së dhe të edukojë stafin profesional në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, për nevojat e organizatave, institucioneve, agjencive dhe industrive të ndryshme. Programi synon të përmbushë kërkesat bashkëkohore për zhvillim profesional, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e vazhdueshëm të kuadrove të kualifikuara.

Qendra e Trajnimit posedon një ekip profesionistësh të specializuar, të cilët operojnë në terren duke zbatuar metodologji të standardizuara dhe praktika të avancuara të hartimit dhe implementimit të programeve. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike;
- Aktivitetet organizative;
- Analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe dëmit;
- Zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë në institucione dhe ndërmarje.

Ndërmarja ofron kapacitete të konsoliduara në organizimin e trajnimeve dhe këshillimeve profesionale në fushën e SSHP-së. Ajo orienton dhe përcakton kushtet e sjelljes në punë,



ndihmon në hartimin dhe përditësimin e rregulloreve të brendshme, si dhe në përpilimin e raporteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të harmonizuar me direktivat evropiane.

Analiza e rreziqut mbetet një komponent vendimtar i menaxhimit të sigurisë. Ajo duhet të marrë parasysh të gjitha rreziqet dhe situatat e pasigurta, duke garantuar që reduktimi i një rreziku të mos shkaktojë rritjen e një tjetri. Vetëm përmes një qasjeje të balancuar sigurohet reduktimi efektiv i ekspozimit të punëtorëve dhe palëve të tjera të pranishme (vizitorë, kontraktorë, kalimtarë të rastësishëm) ndaj rreziqeve të mundshme.



2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I PROGRAMIT	Program trajnimi për specialistët Avancuar të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP)
KËRKESAT MINIMALE PËR ARSIMIN E MËPARSHËM	Për të arritur këtë kualifikim, kandidatët duhet të kenë të paktën arsimin e mesëm ose profesional dhe kualifikimi si specialist themelorë i SSHP-së - 60 orë.
QËLLIMI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT	Ky program synon të pajisë kandidatët me njohuri dhe aftësi profesionale për: - Të sigurojë njohuri të avancuara dhe aftësi profesionale për specialistët e SSHP-së lidhur me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendet e punës me rrezik të lartë; - Të aftësojë pjesëmarrësit në trajtimin e temave kyçe të sigurisë dhe shëndetit në punë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet bashkëkohore të industrive specifike me rrezik të lartë, si ndërtimtaria, prodhimi, transporti, bujqësia, pylltaria dhe/ose minierat; - Të mundësojë zhvillimin e kompetencave profesionale të nevojshme për krijimin, implementimin dhe funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të SSHP-së brenda një kompanie me rrezik të lartë dhe me deri në 50 punonjës; - Të forcojë kapacitetet profesionale për zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse, duke përfshirë hartimin e procedurave, udhëzimeve dhe planeve të veprimit në përputhje me natyrën e industrisë; - Të përgatisë kandidatët që të kontribuojnë në mënyrë efektive në promovimin dhe ngritjen e kulturës së sigurisë dhe shëndetit në punë, duke siguruar një qasje proaktive dhe të qëndrueshme ndaj menaxhimit të rrezikut në sektorët me rrezik të lartë.
KOHËZGJATJA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT	Programi ka një kohëzgjatje prej 20 orësh mësimore gjithsej, të cilat përbëhen nga orë teori, praktikë, vlerësim dhe vetë-studim.
FORMA E TRAJNIMIT	Prania fizike në trajnim, me sesione prej 10 orësh .
FLEKSIBILITETI	Qendra e trajnimit ka të drejtë të bëjë deri në $\pm 10\%$ ndryshime në numrin e orëve të kontaktit për pjesën teorike, me kusht që të mbulohen të gjitha temat e përcaktuara në kurrikulën e trajnimit.
DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR ARSIMOR	Certifikata e pjesëmarrjes në trajnim, dhënia e provimit dhe marrja e kualifikimit të specialistit të avancuar të sigurisë dhe shëndetit në punë në një fushë specifike.
MUNDËSITË PËR ARSIMIM TË MËTUTJESHËM	Pas mbarimit të suksesshëm të trajnimit për specialistët të Avancuar të SSHP, personi mund t'i nënshtrohet trajnimit për t'u bërë një ekspert i shëndetit dhe sigurisë në punë.
TRAJNERËT E QENDRËS	Trajnerët kanë Certifikatë të vlefshme të Trajnerit, në përputhje me Rregulloren (MPMS) Nr. 01/2021 mbi Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e



	Kompanive të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Kompanitë e Trajnimit.
REFERENCA LIGJORE	<i>Rregullore (MPMS) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.</i>



3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR SPECIALIST TË AVANCUAR TË SSHP-SË

Ky program është strukturuar mbi fusha të përcaktuara qartë, të bazuara në tema shumëdimensionale që çdo specialist i ardhshëm i SSHP-së duhet t'i njohë, t'i zotërojë dhe t'i praktikojë gjatë trajnimit.

Programi ka natyrë komplekse dhe realizimi i tij nënkupton një proces më afatgjatë, ku secili kandidat do të ketë mundësi të përfshihet në një transformim profesional e personal, duke ndjekur vizionin e arsimit të integruar dhe duke reflektuar këto aftësi në praktikën institucionale.

Tabela 1. Ndarja e moduleve sipas orëve

NR.R.	MODULET/TEMAT	TEORI	PRAKTIKË
1	Situata e përgjithshme në industrinë me risk të lartë. Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale	2	0
2	Faktorët specifikë të riskut në vendin e punës për industrinë, duke përfshirë nivelet tipike të faktorëve të riskut	3	2
3	Masat parandaluese specifike për industrinë të faktorëve të riskut në vendin e punës	3	2
4	Ndihma e parë dhe planifikimi i emergjencave	2	0
5	Puna praktike	0	6
Gjithsej:		10 orë	10 orë

Vërejtje: Në kuadër të programit të trajnimit për Specialist të Avancuar të SSHP-së do të përdoren literaturë të përditësuara, makete dhe shembuj praktik, analiza dhe studime profesionale.

Literaturat dhe materialet do të rifreskohen sa herë të jetë e nevojshme, përfshirë edhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi.



4. OFERTA FINANCIARE

Përfshirja e trajnimit si bazë e ofertës financiare

Çmimi i përgjithshëm për zhvillimin e trajnimit të përshkruar më lart, në kuadër të implementimit të programit nga fusha e SSHP-së, është paraqitur sipas kërkesës. Ky çmim përfshin tërësisht angazhimet e nevojshme për realizimin e programit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Në çmim janë të mbuluara:

- Shërbimet e trajnerëve të licencuar dhe me përvojë në fushën përkatëse;
- Materialet shpenzuese të nevojshme gjatë procesit të trajnimit;
- Materialet zhvilluese të programit, të përgatitura sipas standardeve dhe kushteve akredituese;
- Koordinimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i procesit të implementimit të trajnimit.

Oferta bazë e zhvillimit të programit trajnues 20 orë:		
M1: Situata e përgjithshme në industrinë me risk të lartë. Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale	1.00	€ 100.00
M2: Faktorët specifikë të riskut në vendin e punës për industrinë, duke përfshirë nivelet tipike të faktorëve të riskut		
M3: Masat parandaluese specifike për industrinë të faktorëve të riskut në vendin e punës		
M4: Ndihma e parë dhe planifikimi i emergjencave		
M5: Puna praktike		
TOTAL PËR KANDIDAT:		100.00 €

Sqarime shtesë:

Kandidatët janë të obliguar të mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të shujtave ditore gjatë periudhës së trajnimit.